



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 151, datë 21.12.2015

PËR

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 127 DATË 06.10.2011 “MBI
PËRMBAJTJEN E DETYRUESHME, AFATET DHE FORMËN E RAPORTEVE TË
SIK, SHOQËRIVE TË ADMINISTRIMIT DHE DEPOZITARËVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve të Pensioneve, të Tregut të Fondeve të Investimeve dhe të Titujve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 127, datë 06.10.2011 “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të SIK, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Pensioneve, Fondeve të Investimit, Titujve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI

Në Rregulloren nr. 127, datë 06.10.2011 “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të SIK, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në fund të nenit 1, objekti, shtohet pika e) me këtë përmbajtje:

“e) Raporte të mbikëqyrjes së likuiditetit për Fondet e Investimit. (Shtojca 7)”

2. Pas nenit 24, shtohen nenet 25 dhe 26, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 25

Raporte të mbikëqyrjes së likuiditetit për Fondet e Investimit

1. *Raportet e mbikëqyrjes së likuiditetit për secilin nga fondet e investimit duhet të përfshijnë:*

- a) *Raportin ku përshkruhen supozimet dhe rezultatet e provave të rezistencës, si dhe planin e miratuar për veprim nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë;*
- b) *Metodologjinë për llogaritjen e vlerës gjithsej neto të flukseve monetare dalëse të parashikuar dhe llogaritjen mbi këtë bazë të masës së ALCL, sipas përcaktimeve të nenit 10 të Rregullores nr. 45, datë 30.06.2015, “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve”.*
- c) *Llojin dhe tiparet e fondit të investimit;*
- d) *Treguesit e portofolit, të tillë si vlera totale e aseteve, struktura e aseteve sipas periudhave të maturimit, likuiditeti dhe kthyeshmëria;*
- e) *Masën e ALCL dhe ndryshimin e saj, si dhe treguesit, sipas përcaktimeve të nenit 10 të Rregullores nr. 45, datë 30.06.2015, “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve”;*
- f) *Informacion mbi asetet e mbajtura në portofolin e fondit të investimit, të tilla si:*

- i. *Tiparet e secilit aset, si emri, shteti, kategoria e emetuesit, rreziku ose periudha e maturimit dhe vlerësimet e brendshme;*
- ii. *Llojin e secilit aset, ku përfshihet informacion i hollësishëm për palën e tretë në rastin e instrumentave derivativë ose të marrëveshjeve të riblerjes;*

g) *Informacion mbi detyrimet e fondit të investimit, që përfshin:*

- i. *Vendin ku qëndron investitori;*
- ii. *Kategorinë e investitorit;*
- iii. *Aktivitetin e kontributeve dhe shlyerjeve nga anëtarët e fondit.*

2. *Shoqëria administruese e fondit të investimit duhet të raportojë për secilin fond nën administrim informacionin mbi shlyerjet neto.*
3. *Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive, në fund të çdo tremujori duhet të raportojë vlerësimin e tregut në përputhje me kërkesat e nenit 4/1 të rregullores nr. 77, datë 29.06.2011, ndryshuar.*
4. *Përmbajtja dhe forma e raporteve të mbikëqyrjes së likuiditetit për fondet e investimit përcaktohen në Shtojcën 7, e cila është pjesë integrale e kësaj rregullore.*

Neni 26

Afatet për dorëzim të raporteve të mbikëqyrjes së likuiditetit për fondet e investimit

1. *Shoqëria administruese e fondit të investimit, për secilin fond që administron, duhet të raportojë çdo vit në Autoritet, brenda tremujorit të parë, dhe sa herë Autoriteti e kërkon ose ka ndryshime, raportet e përcaktuara në shkronjat a) dhe b) të pikës 1 të nenit 25 të kësaj rregulloreje.*
 2. *Shoqëria administruese e fondit të investimit, për secilin fond që administron, së bashku me pasqyrat financiare të tyre, duhet të raportojë në Autoritet informacionin e përcaktuar në shkronjat c), d), e), f) dhe g) të pikës 1 si edhe në pikën 3 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, sipas afateve të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të nenit 16 të kësaj rregulloreje.*
 3. *Shoqëria administruese e fondit të investimit për secilin fond nën administrim, duhet të raportojë çdo dy javë, informacionin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 25 të kësaj rregulloreje.*
 4. *Në rast se treguesi i mbulimit të likuiditetit bie nën 1 ose nën nivelin e përcaktuar nga Autoriteti, shoqëria administruese pasi njofton menjëherë Autoritetin dhe depoziton menjëherë një plan masash për përmirësimin e raportit të likuiditetit dhe respektimin e nivelit të tij, duhet të raportojë gjendjen ditore në fund të çdo dite, për aq kohë sa Autoriteti nuk ka vendosur ndryshe.*
 5. *Autoriteti mund të kërkojë informacion shtesë ose raportim më të shpeshtë në lidhje me mbikëqyrjen e likuiditetit, nëse e gjykon të arsyeshme.”*
3. Në fund fjalët “Neni 25 Hyrja në Fuqi” bëhen “Neni 27 Hyrja në Fuqi”.
4. Pas shtojcës 6, shtohet shtojca 7, me titull “Raporte të mbikëqyrjes së likuiditetit për Fondet e Investimit” (tabelat bashkëlidhur).